



GRT.0070

## GROUT 6

Betonçinë e rrjedhshme, reoplastike, strukturore me tërheqje të kontrolluar

### Kodi doganor

3824 5090

### Amballazhimi

- Qese 25 kg
- Koli: 50 x (Qese 25 kg)

### Aplikimi

- Rrjedhje

Familja  
Grout

Tipologjia  
Llaçe çimentoje të rrjedhshëm strukturorë

Linjat e produkteve  
• Building  
• Infratech

Kategoritë e përdorimit  
• Riparime të përgjithshme të strukturave në beton me llaçe të rrjedhshëm  
• Ndërhyrje mirëmbajtjeje të rrugëve dhe veprave komunitare  
• Ndërhyrje strukturore mirëmbajtjeje për diga, vaska, ujësjellësa dhe kanalizime hidrike  
• Ndërhyrje mirëmbajtjeje të urave dhe viadukteve  
• Ndërhyrje strukturore mirëmbajtjeje të tuneleve dhe galerive  
• Ankorime strukturore të sakta

Përbërësit  
Monokomponent

Paraqitja  
Pluhur

## Certifikimi dhe rregulloret



### EN 1504-6

Produkte dhe sisteme për mbrojtjen dhe riparimin e strukturave të betonit - Përforcimi i çelikut për ankorim



### EN 1504-3

Produkte dhe sisteme për mbrojtjen dhe riparimin e strukturave në beton - Riparime strukturore dhe jo strukturore (R4)

## Përshkrimi i produktit

GROUT 6 është një llaç i rrjedhshëm me veti shumë të larta, me fibra të përforcuara polipropeni, e përdorur për reintegrim strukturor në beton të përforcuar, me veti shumë më të larta të rezistencës mekanike në ngjeshje dhe në përkulje shumë më të lartë se betonçinet normale strukturore.

## Të dhëna shtesë

Aftësi ANTIKORROZIVE dhe MBROJTËSE TË SHFRAVE E ARMATURËS; pikat më të forta të GROUT 6 janë:

- Miksimi i lidhjeve me një rezistencë të lartë, të kombinuara me silice shumë finë me një aktivitet të lartë pocolanik, i bëjnë llaçet në fund të procesit të ngurtësimit, tepër të papërshkueshëm nga uji;
- pH fortësisht alkaline (> 12) mbron shufrat e armaturës nga rreziku i korrozionit;
- avullimi i papërfillshëm i anidritit karbonik i jep llaçeve të ngurtësuara vetit shumë të larta antikarbonizuese.

Tërësia e këtyre veçorive antikorrozive ndihmon në ruajtjen e shufrave të armaturës gjatë hedhjes së llaçit të rrjedhshëm, duke bërë JO TË NEVOJSHME, gjithnjë që, nga veprimet e pastrimit të metalit të bardhë dhe hedhjes së llaçit, të mos kalojë shumë kohë, me rrezikun e nisjes së proceseve oksiduese. Kështu, në rastet kur parashikohet një kohë e gjatë ekspozimi ndërmjet veprimeve të pastrimit të shufrave dhe hedhjes së llaçit, këshillohet një trajtim me bojakë pasive (REPAR MONOSTEEL o REPAR STEEL), e shtrirë me brushë dhe e lokalizuar vetëm në armaturat prej çeliku.

## Fushat e përdorimit









Përmirësime strukturore, rregullime të përmasave, konsolidime, ankorime me përmasa të larta, punime të mbushjes dhe të blindimit, etj., nëpërmjet hedhjeve të pompuara ose të derdhura në vend. Ndërtimi i nyjeve rrugore strukturore.



[www.azichem.com](http://www.azichem.com)

Përditësimi më: **10/06/2021**  
Kushtet e shitjes dhe parashikimet ligjore mund të lexohen në [www.azichem.it/disclaimer](http://www.azichem.it/disclaimer)

## Vetitë kryesore

 Jetëgjatësia: 12 muaj	 Përmasa maksimale e agregatit: 6 mm
 Përzierja me ujë: 10-12 %	 Pot life: 60 min
 Temperatura e aplikimit: +5 / +35 °C	 Trashësia maksimale e lejueshme: 30 cm
 Trashësia minimale e lejueshme: 1(*) - 4 cm	 Ngjyrat në dispozicion Gri

## Veçoritë teknike

Lidhja e aderimit (UNI EN 1542):  $\geq 2 \text{ N/mm}^2$

Masa vëllimore (UNI EN 1015-6):  $2190 \text{ kg/m}^3$

Moduli elastik (EN 13412):  $30000 \text{ N/mm}^2$

Ngjitje në beton (prova për prerjen):  $> 5 \text{ MPa}$

Përcaktimi i kompaktësisë termike (UNI EN 13687-1):  $\geq 2 \text{ mPa}$

Përmbajtja e klururit (UNI EN 1015-17):  $< 0.01 \%$

Përthitha kapilare (UNI EN 13057):  $0.49 \text{ kg} \cdot \text{h}^{0.5} / \text{m}^2$

Reagimi ndaj zjarrit (EN 13501-1): A1 \_

Resistenca e vidhosjes së shufrave të çelikut me aderim e përmirësuar:  $> 30 \text{ MPa}$

Resistenca nga karbonizimi (UNI EN 13295): 0.5 mm

Resistenca nga rrëshqitja (UNI EN 13036-4): 50 mm

Rezistenca nga ngjeshja (UNI EN 1015-11):  $> 70 \text{ N/mm}^2$

Rezistenca nga përkulja (UNI EN 1015-11):  $> 8 \text{ N/mm}^2$

## Mjetet e pastrimit

- Ujë

## Shtresat e lejuara

- Beton
- Parafabrikuara
- Muratura të përziera
- Shufra armature të oksiduar

## Mënyra e përdorimit

Fusni në betonierë 2/3 (rreth 2.5 litra për qese) e ujit të përzierjes totale, pastaj shtoni gradualisht produktin dhe ujin e mbetur, duke u përpjekur të arrini një përzierje homogjene të konsistencës së dëshiruar dhe pa toptha.

Për seksionet e larta të ngulitjes është e këshillueshme të shtoni GHIAIETTO 6.10 (shih fletën përkatëse të të dhënave teknike për informacione të mëtejshme).

## Përgatitja e shtresave (mbështetëse)

Shtresat mbështetëse duhet të jenë të pastra, pa njollasje, pjesë të shkatërruara dhe të paqëndrueshme, pluhur etj. të ngopura sa duhet me ujë derisa të arrijnë kushtet e "ngopjes së sipërfaqeve të thata".

## Magaznimi e Ruajtja

Ruajeni produktin në ambalazhimin origjinal, në një mjedis të freskët dhe të thatë, duke shmangur acarin dhe rrezet e drejtpërdrejta të diellit. Ruajtja e papërshtatshme e produktit mund të shkaktojë humbje të vetive reologjike. Mbrojeni nga lagështia.



[www.azichem.com](http://www.azichem.com)

Përditësimi më: **10/06/2021**  
Kushtet e shitjes dhe parashikimet  
ligjore mund të lexohen në  
[www.azichem.it/disclaimer](http://www.azichem.it/disclaimer)



## Paralajmërimi, Masa paraprake, **Ekologji**

Të dhënat e përgjithshme, ashtu si dhe indikacionet dhe sugjerimet për përdorimin e këtij produkti, të paraqitura në këtë fletë teknike të të dhënave dhe mundësisht të shpjguara dhe me gojë ose me shkrim, përputhen me gjendjen aktuale të njohurive tona shkencore dhe praktike.

Të dhënat teknike dhe të performancës të paraqitura janë rezultat i provave laboratorike të kryera në një mjedis të kontrolluar dhe si të tilla mund të ndryshojnë në lidhje me kushtet e vënies në funksionim.

Azichem Srl nuk merr asnjë përgjegjësi që rrjedhin nga performanca jo e duhur që ka lidhje me përdorimin jashtë rregullave të produktit, ose që ka lidhje me defektet që rrjedhin nga faktorë ose elementë që nuk kanë lidhje me cilësinë e produktit, duke përfshirë këtu dhe konservimin e pasaktë.

Kushdo që synon të përdorë produktin duhet të vendosë, para përdorimit, nëse është i përshtatshëm për përdorimin e synuar, duke marrë përsipër të gjithë përgjegjësinë e tij.

Karakteristikat teknike dhe të performancës të përfshira në këtë fletë të dhënash teknike përditësohen në mënyrë periodike. Për një konsultë në kohë reale lidhuni me sitin: [www.azichem.com](http://www.azichem.com). Data e rishikimit paraqitet në cep të produktit. Ky njoftim anulon dhe zëvendëson çdo njoftim tjetër të mëparshëm.

Mos harroni se përdoruesi është i detyruar të lexojë Fletën më të fundit të të Dhënave të Sigurisë së këtij produkti, që përmban të dhëna kimike-fizike dhe toksikologjike, parashikimet e rrezikut dhe informacione të tjera me qëllim që të transportojë, përdorë dhe asgjësojë produktin dhe paketimin e tij me siguri të plotë. Për konsultim lidhuni me sitin: [www.azichem.com](http://www.azichem.com).

Ndalohet hedhja e produktit dhe / ose amballazhit të tij në mjedis.

Duke pasur parasysh autonivelueset e produktit dhe aftësinë e tij autokompakte, këshillohet të bëhet kujdes në fazën e vibrimit. Një shtim më i madh i vibrimit mund ta përkeqësojë pamjen estetike të produktit përfundimtar.

Mos e përdorni pa kufizueset e duhura anësore.

Kujdesuni për mbrojtjen nga lagështia të sipërfaqeve të ekspozuara.

Zbatoni procedura të hedhjes në mënyrë të tillë që të mos ketë boshllëqe dhe shkëputje; derdheni llaçin vetëm në një rënë anë të perimetrit të hedhjes me qëllim që të mënjanoi bulëzat e ajrit.

*GROUT 6 prodhohet/shpërndahet nga*



[www.azichem.com](http://www.azichem.com)



Via Giovanni Gentile, 16/A - 46044 Goito (MN), Itali  
[info@azichem.com](mailto:info@azichem.com) Tel. +39 0376.604185 /604365 Fax +39 0376 604398

Përditësimi më: **10/06/2021**  
Kushtet e shitjes dhe parashikimet  
ligjore mund të lexohen në  
[www.azichem.it/disclaimer](http://www.azichem.it/disclaimer)